

SHOQERIA “BALLA – SK”
AKTIVITETI: IMPIANT PRODHIMI INERTESH

PERMBLEDHJE NE GJUHE JO-TEKNIKE
IMPIANT PER PRODHIMIN E PRODUKTEVE INERTE
DURRES, BASHKIA DURRES, NJESIA ADMINISTRATIVE VENDORE RRASHBULL,
FSHATI BOZANXHIE



Bazuar ne Ligjin 60/2014 Shtojca I “Per Lejet e Mjedisit” aktiviteti “Impiant Prodhimi Inertesh” klasifikohet ne I.D 3.10 Prodhimi i produkteve minerale jometalore

Referuar Vendimit Nr. 419, date 25.6.2014, Kreu III Procedrat per shqyrtimin e kerkesave dhe percaktimi i kushteve per leje mjedisi te Tipit B, pika 1.dh Shoqeria “BALLA – SK” aplikon per zhvillimin e procesit te degjeses me publikun, sipas pikes 13 te kreut VI te ketij vendimi.

Shoqeria “BALLA – SK”

Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise

Skender Balla

ANEKSI XIV

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Shoqeria "BALLA – SK" Sh.p.k aplikon per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B, per impiante dhe instalime te reja, referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" te Ligjit Nr. 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" Shtojca 1 (e ndryshuar) "**Industria minerare, ID 3.10, Veprimtaria: Prodhimi I produkteve abrasive dhe produkteve te tjera minerale jometalike**", **Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet.**

Ne impiantin e prodhimit te produkteve inerte jane te punesuar 8 punonjes. Impianti eshte instaluar ne siperfaqen e tokes ne pronesi te familjes Skender Balla.

AKTIVITETI: IMPIANT PRODHIMI DHE FRAKSIONIMI INERTESH

Adresa: Godine private 1 – kateshe, prane Qendres, Bozanhije, Rrashbull, Durres.

Subjekti: "BALLA – SK" Sh.p.k

NIPTI K92020502I

Administrator: Z. Skender Balla

Celular +355 69 872 9239

Email: balla-sk@gmail.com

1. Hyrje

Profili i shoqërisë "BALLA-SK" për prodhimin dhe fraksionimin e inerteve

Instalimi per prodhimin dhe fraksionimin e inerteve me dimensione te ndryshme të shoqërisë "BALLA – SK" shpk është i vendosur ne te majte te rruges nacionale Pjeze-Tirane, në Fshatin Bozanhie, Njesia Administrative Rrashbull, Durres, ne nje distance rreth 700 m nga rruga kryesore dhe rreth 350 nga Shtrati i Lumit "Erzen". Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit me shumice dhe pakice te inerteve e te materialeve te ndertimit me ane te prodhimit te tyre me materiale te gatshme dhe jo te gatshme, me NR NIPT: **K92020502I**. Sheshi ku eshte instaluar impianti i prodhimit te inerteve eshte i niveluar dhe si bazament per linjen teknologjike sherbejne pilotat te nguluara ne toke, ku dhe eshte montuar linja e fraksionimit te inerteve, pjesa ku eshte ndertuar kulla e vrojtimit dhe paneli i kontrollit eshte e shtuar me beton, gjithashtu eshte ndertuar nje mure mbajtes prej betoni i cili sherben per shkarkimin e lendes se pare, pjesa tjetere e sheshit ku zhvillohet veprimtaria eshte e shtuar me cakull dhe e niveluar, gjithashtu eshte ndertuar rrjeti i drenazhimit te ujrave te shiut dhe ujrave teknologjike qe gjenerohen nga impianti i fraksionimit.

Objekti ka nje siperfaqe relativisht te vogel i perbere nga impianti dhe hapesirat e nevojshme per kete aktivitet duke shfrytezuar te gjitha ambjentet per kete linje prodhimi. Siperfaqja e pergjithshme e sheshit eshte rreth 5 600 m² dhe eshte ne pronesi te vete pronarit te subjektit.

• Siperfaqe totale ne pronesi	5600 m ²
• Siperfaqja e sheshit te ndertimit	3300 m ²
• Siperfaqja e pultit te komandimit	12 m ²
• Siperfaqja e zyrave	32 m ²
• Siperfaqja e magazines	16 m ²
• Siperfaqja e impiantit te inerteve	800 m ²
• Siperfaqja totale e ndertimit	864 m ²

Informacion mbi kompanine "BALLA - SK" sh.p.k

Shoqeria **"BALLA - SK" sh.p.k** eshte nje subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e prodhimit te inerteve nga materialet e gatshme dhe jot e gatshme edhe punime te ndryshme per objekte civile. Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Per kete qellim, subjekti **"BALLA - SK" sh.p.k** referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" ka plotësuar Formularit e Kerkeses per tu pajisur me Leje Mjedisit te Tipit B per aktivitetin Impiant per prodhimin e inerteve, ne Njesine Administrative Rrashbull, Bozaxhie, Durres. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjeticke, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është të prodhojë produktet dhe nenproduktet inerte për perballimin e kerkesave te sektorit te ndertimit, infrastruktures, industrise etj.

2. Të dhëna mbi impiantin e instaluar

Shoqëria **"BALLA – SK" shpk** si firmë me aktivitet në fushën e veprimtarisë së prodhimit të inerteve, ka investuar dhe disponon impiantet/makineritë e domosdoshme për zhvillim e proceseve kryesore në prodhimin e produktit përfundimtar rere natyrale, granil 1 dhe 2, rere e thyer.

Pjeset kryesore te linjes se prodhimit te inerteve jane:

1. Pedane e Furnizimit
2. Bunker, Ushqyes
3. Transportier kryesor 20.4 ml, Nr.1
4. Site Vibruese me 2 Kate
5. Transportier Kryesor 20.4 ml, Nr.2

6. Site Vibruese me tre kate 400x150
7. Laresi Nr.1, 2x1.2 ml
8. Rera natyrale
9. Frontoje, Gurethyes me nofulla
10. Transportier i Cakellit 12.4 ml
11. Transportier i produktit te frontojes 10.4 ml
12. Laresi Nr.2
13. Rera e thyer
14. Mulliri Sekondar
15. Transportier Granili Nr. 1, 12.4 ml
16. Transportier Granili Nr. 2, 12.4 ml
17. Transportier i produktit te mullirit 12.4 ml
18. Pulti i Komandimit

2.1 Pershkrim i pergjithshem

Impianti i fraksionimit dhe prodhimit te inerteve funksionon mbi bazen e nje procesi te thjeshte fizik, i cili ben te mundur qe lenda e pare inerte malore, e cila vjen nga kompani te licencuara dhe ka permasa te kokrrizave te medha, i nenshtrohet proceseve fizike ne linjen e fraksionimit te inerteve, duke perftuar ne kete menyre produktin e deshiruar per tregun rajonal.

Hapat qe ndiqen ne impiantin e fraksionimit te inerteve malore jane:



Pedane e Furnizimit → Bunker Ushqyes → Transportier kryesor 20.4 ml, Nr.1 → Site Vibruese me 2 Kate → Transportier Kryesor 20.4 ml, Nr.2 → Site Vibruese me tre kate 400x150 → Laresi Nr.1, 2x1.2 ml → Rera natyrale → Frontoje, Gurethyes me nofulla → Transportier i Cakellit 12.4 ml → Transportier i produktit te frontojes 10.4 ml → Laresi Nr.2 → Rera e thyer → Mulliri Sekondar → Transportier Granili Nr. 1, 12.4 ml → Transportier Granili Nr. 2, 12.4 ml → Transportier i produktit te mullirit 12.4 ml → Pulti i Komandimit

Parashikimi i realizimit të prodhimit

Kapaciteti prodhues i kompanise eshte:

- **50 m³/ore inerte** (Granil 1, Granil 2, Rere e thyer dhe Rere natyrale)

2.2 Produktet kryesore te impiantit te prodhimit te inerteve

Kompania "BALLA - SK" sh.p.k ne linjen e vet te inerteve prodhon kater produkte kryesore me prejardhje inerte malore. Seicili nga produktet ka perberje cilesore te ndryshme, ne varesi te trajtimit fizik qe i eshte nenshtruar lenda e pare ne impiantin e fraksionimit, produktet e perftuara jane:

- Rere Natyrale
- Rere e Thyer
- Granil 1
- Granil 2

2.2.1 Procesi teknologjik ne impiantin e prodhimit te inerteve

- Pedane e Furnizimit me lende te pare

Pedana sherben per mbushjen e Bunkerit Ushqyes me lende te pare. Pedana eshte projektuar me mure mbajtese prej betony, eshte mbushur me materiale inerte dhe eshte vendi ku makinat e shkarkimit kolojne me qellim furnizimin e impiantit me lende te pare. Lartesia e perdanes eshte 4 m mbi nivelin e tokes dhe ka nje pjerrresi prej 35 ° e cila ndihmon ne ngjitjen dhe zbritjen e mjeteve te transportit.

- Bunker Ushqyes

Bunkeri ushqyes mund te quhet dhe hapi i pare qe ndodh ne procesin e furnizimit te impiantit me lende te pare. Ky bunker ka nje kapacitet prej 60 m³ dhe eshte i mjaftueshem per furnizimin e impiantit me lende te pare per 1 ore. Bunkeri furnizohet here pas here me lende te pare nepermjet pedanes se furnizimit, ku mjetet shkarkojne lende e pare te destinuar per fraksionim. Bunkeri ushqyes lidhet me pjesn tjetër te impiantit nepermjet transportierit kryesor. Bunkeri ka formen e nje hinke ne fund, e cila nepermjet vibrimeve te lehta furnizon transportier me lende te pare ne menyre periodike.

- Transportieri kryesor 20.4 ml, Nr.1

Transportieri kryesor Nr. 1 i cili ka nje gjatesi per 20.4 metra linerar realizon procesin e furnizimit te sites vibrues. Ky transportier eshte i pajisur me rrypa me transmission dhe me rrula, te cilet ventosen ne pune nepermjet energjise elektrike. Transportieri ka nje numer xhirosh te ngadalte dhe ne kahun orar. Gjtithashtu rrypat e transportier jane prej gomine te ashper ne menyre te tille qe te mos kemi rrjedhje te lendes se pare.

- Site vibruese me 2 kate

Sita vibruese furnizohet nga transportieri kryesore, lenda e pare kalon ne siten vibruese e cila eshte e perbere nga dy kate, Lenda e pare fillimisht kalon ne katin e pare te sites, ku kryhet procesi i ndarjes se sterileve sipas granulometrise se tyre (madhesia e kokrrizes). Procesi kryesor i sites eshte ndarja e reres natyrale nga permbajtja qe ka lenda e pare. Ne katin e dyte te sites vibruese depozitohet rera natyrale e papaster, e cila ne permbatje te saj ka edhe % te dheut, ashtu sikurse ka ardhur na mali. Pastaj lendet e para te ndara sipas granulometrise perkatese kalojne ne proceset e tjera te impiantit.

- **Transportier kryesor 20.4 ml, Nr.2**

Ne vazhdimesi te procesit te Sites vibruese me 2 kate, eshte instaluar transportieri kryesor Nr.2 i cili gjithashtu ka nje gjatesi prej 20.4 metra liner. Mund te themi se ky transportier realizon procesin me kryesor te impiantit, pasi furnizon te gjitha instalimet me lende te pare te paperpunuar. Ky transportier furnizon me lende te pare siten vibruese me 3 kate.

- **Site vibruese me 3 kate 400x150**

Sita vibruese me 3 kate, ben te mundur ndarjen ne tre produkte kryesore, duke ju afruar fazes perfundimtare te produktit perfundimtar. Vibrimet e lehta qe i behen lendes se fraksionuar deri ne kete process, ben te mundur ndarjen e saj ne tre paraprodukte:

Granil 1

Granil 2

Rere e thyer

- **Larese Nr. 1, 2x1.2 ml**

Pas fraktionimit te lendes se pare qe vjen nga transportieri kryesor Nr. 1, e cila kalon ne siten vibruese me 2 kate. Lendet me te imete te cilat precipitohen ne katin e dyte te sites, nepermjet nje transportieri kalojne ne Laresin Nr.1.

Lendet me te imete kane ne permbajtje te tyre papasterit te ndryshme, te cilat eliminohen nepermjet perzierjes se njetrajtshme te saj ne laresin Nr.1. I gjithë procesi ndodh ne prani te ujit dhe tryeles spirale e cila ven ne levizje lenden e pare, duke ndare papasterite vecmas dhe produktin rere natyrale e dergon ne transportier ku me pas depozitohet ne sheshin e instalimit.

- **Rere natyrale**

Rera natyrale perftohet nga fraksionimi i lendes se pare dhe nga procesi i larjes ne laresin Nr.1, eshte nje process i shkurtes, por qe zgjat, pasi permbajtja e reres natyrale ne lenden e pare eshte ne % shum te vogel.

Ky produkt eshte i gatshem per konsum sipas kerkesave dhe kontratave te furnizimit qe shoqeria ka me palet e treat.

- **Frontoje, Gurethyesi me Nofulla**

Pas procesit te sites vibruese me dy kate, lenda e pare me madhesi kokrrize me te madhe kalon ne transportierin e cakullit me gjatesi 12.4 metra linear i cili perfundon ne gurethyesin me nofulla. Madhesia e kokrrizave varion ne varesi te lendes se pare. Qellimi i kesaj makinerie eshte thyerja e kokrrizave me madhesi me te madhe dhe perftimin e kokrrizave me diameter me te vogel. Procesit qe ndodh eshte ai i therrmimit t cakullit npermjet nofullave, duke e bluar ate ne kokrriza me te vogla dhe dergimin e tyre nepermjet transportierit me gjatesi 10.4 metra linear ne transportierin kryesor Nr. 2 me qellim qe ti nenshtrohet proceseve te tjera.

- **Transportier i cakellit 12.4 ml**

Transportieri i cakellit merr produktetin me madhesi me te madhe qe del nga sita vibruese me 2 kate dhe e dergon ne Gurethyesin me nofulla, ku ndodh dhe procesi i therrmimit te cakullit.

- **Transportier i produktit te frontojes 10.4 ml**

Ky transportier ka nje gjatesi lineare prej 10.4 m, ai sherben per transportimin e lendes se thyer ne gurethyesin me nofulla per tek transportieri kryesor Nr.2 ku me pas lenda e fraksionuar i neshtrohet proceseve te tjera fizike.

- **Larese Nr.2**

Ne kete makineri ndodh procesi i larjes se produktit me granulometri me te vogel, ku perftohet Granili Nr. 1 dhe Rera e thyer. Ky eshte dhe procesi i fundit i heqjes se papastertive nga dherat e ndryshme qe ka ne permbajtje lenda e pare, duke i fraksionuar ne kete menyre llumrat vec te cilat hiqen nepermjet ujit, granilin vec dhe reren e thyer vec, e cila ka dhe granulometrine me te vogel.

- **Transportier i reres se thyer 12.4 ml**

Transportieri i reres se thyer ka nje gjatesi prej 12.4 metra linear dhe transporton produktin e reres se thyer, e cila depozitohet ne sheshin e instalimit.

- **Rera e thyer**

Rera e thyer eshte nje nga produktet e gatshme qe perftohen nga impianti i prodhimit te inerteve. Ky produkt depozitohet ne sheshin e instalimit dhe eshte i gatshem per te plotesuar kerkesat e tregut konsumator.

- **Mulliri Sekondar**

Mulliri Sekondar eshte i instaluar ne vazhdimesi te impiantit te fraksionimit. Inertet me madhesi kokrrize me te madhe, nepermjet forces se rendeses dhe me gravitet kalojne ne mullirin sekondar i cili ben procesin e thyerjes ne kokriza me te vogla, sipas kerkesave te tregut konsumato. Nepermjet ketij procesi perftohet produkti i Granilit Nr.2 me madhesi 10-20 mm. Sasia e produktit i cili nuk arrin te fraksionohet sipas kerkeses kalon edhe nje here ne procesin e sites vibruese nepermjet transportierit te mullirit sekondar dhe transportierit kryesor nr.2. Ky process teknologjik realizohet me qellim rritjen e rendimentit te instalimit dhe permbushjen sa me efektive te kerkesave te produktit perfundimtar.

- **Transportier Granil Nr.1, 12.4 ml**

Transportieri i Granilit Nr.1 ka gjatesi lineare 12.4 metra dhe sherben per transportin e produktit perfundimtar te perftuar. Ky transportier eshte i lidhur me laresin nr.2

- **Transportier Granil Nr. 2, 12.4 ml**

Transportieri i Granilit Nr.2 ka gjatesi lineare prej 12.4 metra dhe sherben per transportin e produktit perfundimtar granil nr.2 per te sheshi depozitimit. Ky transportier eshte i lidhur me mullirin sekondar.

- **Transportier i produktit te mullirit 12.4 ml**

Transportieri i produktit te mullirit ka gjatesi lineare prej 12.4 metra dhe sherben per te rikthyer inertet me madhesi me te madhe se 20 mm te kokrrizes ne procesin e fraksionimit te sites vibruese me 3 kate. Transportieri eshte i lidhur me transportierin kryesor nr.2, duke formuar ne kete menyre nje cikël te mbyllur deri sa te perftohet granulometria e kerkuar e kokrrizes.

- **Pulti i Komandimit**

Pulti i komandimit eshte pika me e larte e impiantit te fraksionimit te inerteve. Nga kjo pike vihen re te gjitha instalimet, duke mbarvajtur dhe proceset fizike qe ndodhin ne impiant. Ne kete pike jane te instaluar te gjitha aparaturat automatike qe kontrollojne te gjitha proceset e impiantit te fraksionimit. I gjithë procesi eshte i automatizuar.

- **Rrjeti i grumbullimit te ujrave teknologjike**

Sasia e ujrave te gjeneruara ne laresin Nr.1 dhe laresin Nr.2 grumbullohet nepermjet rrjetit te drenazhimit i cili eshte i lidhur me puseten kryesore dhe me pas nepermjet kolektorit kryesor te gjitha ujrât bashkohen dhe perfundojne ne vasken e dekantimit te ujrave teknologjike te larjes se materialeve inerte. Gjithashtu rrjeti i drenazhimit sherben dhe per grumbullimin e ujrave te shiut. Kolektori kryesor pastrohet periodikisht, pasi kemi precipitimim te lendeve pezull, te cilat formojne mase kompakte ne formen e llumit.

- **Furnizimi me uje i instalimit**

Nje process tjetër i rendesishem eshte edhe furnizimi me uje i instalimit i cili realizohet nepermjet nje cikli te mbyllur. Ujrât e gjeneruar per larjen e inerteve nepermjet kanaleve te drenazhimit kalojne ne vasken e dekantimit. Ne kete vaske dekantimi jane instaluar dy pompa me kapacitet 100 litra/minut secila te cilat marrin ujin ne vasken e dekantimit dhe e rikthejne ate ne impiantin e fraksionimit te inerteve laresi 1 dhe 2, gjithashtu jane te instaluar dhe disa rrjeta uji per kapjen e grimcave te pluhit ne gurethyesin me nofulla dhe mullirin sekontar. Pra kemi te bejme me nje cikël te mbyllur te furnizimit me uje te instalimit duke perdorur ujin e ricikluar. IMPIANT-VASKE DEKANTIMI – IMPIANT.

- **Hyrja, Zyra, Parking**

Pjese perberese te instalimit jane dhe rruga e brendshme, zyra ku kryhen veprimet ekonomike financiare te shoqerise dhe parking i automjeteve.

- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të impiantit dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejtja e shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti, Magazina, Impianti prodhimit të inerteve në të gjitha ambientet e tyre janë pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme**

Objekti lidhet me rrugën kryesore nacionale Pjeze-Tirane, nepermjet nje rruge dytesore me gjatesi 500 m e cila mundeson komunikimin me instalimin duke mundesuar nje korsi ngadalesimi ne hyrje dhe nje korsi shpejtesie ne dalje nga objekti ne nje distance prej 20 m, cka ben te mundur qe ky objekt te mos ndikojë ne trafikun e zones. Rruga e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjendje mjaft të mire e shtruar me cakull dhe e niveluar sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke mundesuar levizjen e lire te mjeteve te transportit. Gjithashtu pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Planvendosja e impiantit e paraqitur në ortofoto.



Planvendosja e impiantit sipas Gaus Kruger 1942 Zone 4

Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4



Kordinatat e Impiantit të Fraksionimit		
Pikat	X	Y
Qender	4383325.31	4573168.60
1	4383341.53	4573198.57
2	4383371.00	4573186.00
3	4383303.71	4573139.17
4	4383291.98	4573164.43
Koordinata e Oficines		
5	4383393.87	4573350.66

Distanca e Aktivitetit “Prodhim i inerteve ” nga objektet/veprat më të afërta


Drejtimi	Objekti	Distanca	Aktiviteti
Jug	Objekti më e afërt	370 m	Godin banimi
Veri	Objekti më e afërt	360 m	Lumi Erzen
Lindje	Objekti më e afërt	40 m	Shoqeria “Italba Asfalt”
Perëndim	Objekti më e afërt	35 m	Vaske Dekantimi

Kondicionet urbanistike të objektit për prodhim produkteve inerte, janë si më poshtë:

Emri i Tregtar	“BALLA – SK”
Sipërfaqja e zënë nga instalimi	864 m ²
Sipërfaqja në pronësi	5 600 m ²
Veprimtaria	Prodhim i inerteve
Statusi shoqërisë	Aktiv
Vendodhja e Aktivitetit	Fshati Bozanxhie, Godine private 1 kateshe, Komuna Rrashbull, Durres.

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti **“BALLA - SK”** nuk ka shkolla, vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë dhe linjë uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit për **“Prodhim produkteve inerte”**.

IMPIANTI I PRODHIMIT DHE FRAKSIONIMIT TE INERTEVE



2.3 Menaxhimi i Instalimit

Menaxhimi i instalimit behet nga nje staf i kualifikuar dhe trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar aktivitetin e prodhimit te produkteve inerte, per te cilin shoqeria "BALLA – SK" operon ne tregun rajonal. Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj shoqeria konform te gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, eshte organizuar puna ne menyre te tille qe te funksionojne ne formen e nje organograme per realizimin sa me eficient dhe te sukseshem, e cila tregon menyren e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe pergjegjesive te secilit.

Përbërësit kryesorë të këtij programit për menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Certifikuara sipas Standartit Europian dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
- Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të licencuara

- Trajtim i ujrave teknologjike te gjeneruara nga instalimi
- Zhurmat do të jenë të përkoshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;
- Funksionimi;
- Arsyet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjësive dhe vendim marrja;
- Trajnime specifike;
- Monitorimi i cilësisë ajrit;
- Monitorimi i cilësisë ujrave;
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;
- Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;
- Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;
- Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
- Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Kërkesat e mjeteve që do t’ju kryhet shërbimi;

3. Menaxhimi i prodhimit

Për mbrojtjen e instalimit nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i impiantit/makinerve nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj jane marre keto masa:

- Përreth impiantit të prodhimit të inerteve ruhet distance e sigurisë prej 3 m, e cila është vizuar me vijë të verdhë, përgjatë këtij perimetri lëvizin vetëm drejtuesit teknik te impiantit dhe drejtuesi i panelit tekontrollit.
- Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese.
- Eshte instaluar sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato kane) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, ujrat e pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në vasken e dekantimit , këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat jene; lende te aballazheve, letra-kartona, qelqe, si dhe lende organike te gjeneruara nga punonjesit, keto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen ne vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku jane vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane te gjeneruara, depozitohen ne kosha brenda territorit te shoqerise me volum 0.5 m³ prej ku me pas merren nga mjetet e shoqerise dergohen ne koshat e perbashket, nga ku me pas mjetet e pastrimit te bashkise i dergojne ne vendepozitim e caktuar prej tyre. Sasia e mbetjeve urbane te gjeneruara nga punonjesit eshte 0.4kg/dite per person.

- Ne objekt është instaluar një transformator 20 kW i cili furnizon impiantin me energji elektrike, është i tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qendrore të shpërndarjes e cila është e siguruar me celësin e sigurisë, për çfarëdo lloj avarie të mundshme.
- Lënda e parë (inerte malore) depozitohet në bunkerin e lëndës së parë nga ku nepermjet transportierit kryesor kalon në procesin e larjes dhe bluarjes, me pas në varesi të granulometrisë së tyre kalon në proceset e tjera atë të bluarjes me të imet, larjes sekondare deri në përfitimin e produkteve përfundimtare (rere, granil). Furnizimi me lëndë të parë bëhet dhe periodikisht, gjatë gjithë kohës së funksionimit të impiantit. Ndërsa për prodhimin e beto, çakull etj).
- Pajset e reja janë me të avancuara dhe një sërë veprimesh i kanë të automatizuara duke shmangur kështu nderhyrjen e punonjësve dhe të punuarit pranë tyre, për veç të tjerash shoqëria ka disa rregulla strikte të cilat zbatohen me rigorozitet për mos nderhyrjen në makineri gjatë punës, stakimit të energjisë para fillimit të kontrollit apo mirëmbajtjes e remontit të tyre, etj.
- Produkti përfundimtar, sistemohet në sheshin para impiantit, ku me pas nepermjet ruspes me kove me vëllim 3 m³ ngarkohet në kamione dhe dërgohet në destinacionin e kërkuar në varesi të kërkesës që shoqërit e ndryshme kanë dhe në respektim të kushteve të kontratave që ato kanë lidhur me shoqërinë "BALLA – SK".

- **Lëndët e para dhe materialet ndihmëse**

Lënda e parë blihet e gjitha nga subjekte të tjera të lincensuara për prodhimin e saj, nepermjet kontratave që shoqëria ka nëshkruar me subjekte që gjenerojnë lëndë të parë nga karrierat malore. Me lëndën e parë të blerë nënkuptojmë gurin dhe zhavorrin malor. Ndërsa uji sigurohet nepermjet një procesi riciklimi të tij nepermjet vaskës së dekantimit dhe ujërave të shiut.

Materialet malore që do të përdoren për prodhimin e inerteve sipas klasave (granules) të ndryshme do të jenë të cilësishme të lartë dhe konform kushteve të cilësishme për këto produkte. Pasi transportohet lënda e parë depozitohet në bunkerin e lëndës së parë, i cili është dhe roceshi i parë që even në levizje impiantin e prodhimit dhe fraksionimit të inerteve malore.

3.1 Lëndët e para kryesore që përdoren për prodhimin e inerteve është:

- ✓ Gure gelqeror;
- ✓ çakull;
- ✓ Zhavor
- ✓ Sterile të ndryshme malore

3.2 Produktet kryesore të impiantit të prodhimit të inerteve

Kompania "BALLA - SK" sh.p.k në linjen e vet të fraksionimit të inerteve prodhon tre produkte kryesore. Secili nga produktet ka përberje të cilësishme të ndryshme, në varesi të procesit që i nështrohet, duke prodhuar në këto mënyra këto produkte kryesore:

1. Granil 10 – 20
2. Granil 5 – 10

3. Rere guri
4. Rere Natyrale

Kapaciteti prodhues i impiatit te prodhimit te inerteve eshte 50 m³/ore

4. Menaxhimi i lëndëve të para

4.1 Sistemi i transportit

Transportimi i lëndëve të para, të cilat luajnë një rol kyç për operimin normal dhe brenda normave të sigurimit teknik, të proceseve që realizohen në objektin ku është instaluar impianti për prodhimin e produkteve inerte. Transporti sigurohet nga mjetet e shoqërisë “BALLA - SK”, të cilat janë në gjendje shumë të mirë funksionale. Furnizimi me lëndë të para bëhet periodikisht sipas kërkesave dhe funksionimit të impiantit. Mjetet e transportit janë të kolauduara dhe të mbuluara, me qëllim shmangien e rrezikut për humbje apo demtim të lëndës së para dhe produkteve gjatë transportit dhe mbrojtjen e mjedisit. Shpejtësia e lëvizjes së mjeteve është brenda rregulloreve dhe kritereve të transportit të materialeve, në varësi të materialit që transporton.

4.2 Dorëzimi i lëndëve të para

Mjetet e transportit regjistrohen para hyrjes në territorin e objektit. Bëhet verifikimi i materialit që transportohet brenda tyre, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë dhe drejtuesi teknik i operacioneve brenda në objektin e “BALLA - SK” nëse ka mospërputhje të lëndëve të para që janë porositur dhe lëndëve që kanë ardhur në objekt.

Mjetet e transportit parkohen brenda objektit në vendin e caktuar prej shoqërisë, duke ruajtur të gjitha distancat dhe masat e sigurisë, për operimin normal të punës për shkarkimin e ngarkesës (Pedana e furnizimit me lende të para dhe Bunkeri Ushqimit).

Shkarkimi i lëndëve të para realizohet nga vete automjetet respektivisht në Bunkerin e Ushqimit, nën kujdesin e vecantë të drejtuesit teknik dhe masa të mëdha sigurie në varësi të lëndës së para. Pas shkarkimit të materialit, bëhet edhe një here verifikimi i sasisë së marrë në dorëzim, nëse kemi humbje apo rrjedhje të lëndës së para. Drejtuesi teknik sigurohet që ambienti i Bunkerit të Ushqimit janë të sigurt, për ruajtjen në kushtet e kerkuara dhe lageshtise të lendes së para të depozituar.

4.3 Magazina

Bunkeri i Ushqimit që shërben për depozitimin e lendes së para të nevojshme për vendosjen në punë të impiantit për prodhimin e produkteve inerte është në gjendje shumë të mirë, të kolauduara nga inxhinieret e fushës dhe të lyera me boje antikorrodive ndaj kushteve atmosferike dhe agjenteve geryes të lendes së para që depozitohet në to.

Bazamenti mbi të cilin janë vendosur depozitat e lendes së para është projektuar i tillë që mos të kemi erozion, vibrime apo avari të ndryshme gjatë depozitimit dhe funksionimit të linjes së instalimit.

Magazina (Kontajner) do të shërbejë për magazinimin e lëndëve të para plotësuese, pajisjeve/aparaturave ndihmëse dhe pjesëve të këmbimit për impiantin/makinërite. Struktura arkitektonike e magazines i plotësojnë të gjitha kushtet tekniko-inxhinierike për magazinimin e

sigurtë të lëndëve të para me hapësira të bollshme dhe ndricimin e duhur, sipas normave të sigurimit teknik, në varësi të lëndëve të para plotësuese që magazinohen.

4.4 Transporti i brëndshëm

Transporti i brëndshëm i lëndëve të para dhe produkteve të perftuara realizohet nga punonjësit dhe mjetet e shoqërisë, të cilët janë të veshur me pajisjet e posacme për lloj e materialit që transportojnë. Në varësi të distancës së transportit nga vendi i magazinimit në impiantin e prodhimit, përdoren e mjetete të posacme që drejtohen nga punonjësit e firmës, nën kujdesin e drejtuesit teknik, i cili monitoron dhe drejton funksionimin e operacioneve dhe proceseve për shfrytëzimin sa më eficient të lëndës së parë (inerte) dhe instalimit me qëllim arritjen e produkti perfundimtar sipas kërkesave të klienteve dhe standarteve të kërkuara për të tilla procese pune.

4.5 Organizimi i punës dhe fuqia punetore

Puna brenda në objekt është e ndarë qartë, dhe secili prej punonjësve realizon ato procese pune për të cilat ai është ngarkuar nga përfaqësuesi i shoqërisë, procesi i prodhimit është i automatizuar dhe monitorohet nga drejtuesit teknik i linjes së prodhimit të produkteve inerte.

Në të punojnë rreth 8 punonjës, në varësi të kërkesave për produktet inerte nga shoqëria dhe klient të ndryshëm.

Regjimi i punës do të jetë me 1 turn kur shoqëria do të punojë me kapacitet të plotë. Punonjësit e punësuar kanë eksperiencë shumë vjetë në kryerjen e proceseve të ndryshme të prodhimit të lëndëve të para inerte.

Për Menaxhimin e materialeve dhe funksionimin e linjes së prodhimit të inerteve në një ditë të zakonshme pune, skema e funksionimit është shumë e thjeshtë dhe e mirë organizuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë "BALLA - SK" ecuria e punës është si më poshtë:

- Drejtuesit teknik menaxhojnë plotësisht të gjithë rrethin e punës së impiantit të prodhimit të produkteve inerte, duke filluar nga regjistrimi i urdhrave të përditshme, listën e procesimit të kërkesës, llogaritjen e prodhimit, në përputhje me agregatet që do të përdoret dhe sa metra kub do të prodhohen, sasitë e kërkuara të lëndëve të para, menaxhon kohët e dorëzimit dhe shkarkimit, kompenson dhe përmirëson gabimet e prodhimit duke përdorur një sistem vetë-korrigjimi.
 1. Kontrollon në kohë reale ecurinë e variablave të prodhimit dhe paraqet në grafik vizual prodhimin në ore.
 2. Kontrollon dhe koordinon plotësisht proceset e prodhimit (dozimin dhe peshat e materialeve të lëngëta dhe ngurta) dhe ofron informacione të vazhdueshme të konsumit.
- Lejon një gamë të gjerë të programeve të prodhimit nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si:
 - Menaxhimin e Porosive
 - Skedimin dhe menaxhimin e dokumenteve të shpërndarjes, me një rend automatik të printimit në fund të procesit të ngarkimit të impiantit
 - Dokumentet menaxhimit të shpërndarjes madje edhe për ngarkimin manual.

- Menaxhimin e lëndës së parë, kur hyjnë dhe dalin
 - Menaxhimin e përditshëm të prodhimit
 - Programet e mirëmbajtjes së makinerive
 - Ruan një skedar të operacioneve të Impiantit të prodhimit të produkteve Inerte
 - Kontrollon parametrat për shfrytëzimin më të mirë të aftësive të linjes së prodhimit.
- Drejtuesi i Panelit të Kontrollit
- Automatikisht (duke përdorur sensorë) ose manualisht kundër balancon ujin për lagështirën e agregateve që nevojitet për larjen e produkteve
 - Në rast të mungesës, ajo përcjell lëndë të para alternative për përdorim.
 - Parashikon dhe llogarit avancën e ujit dhe kundër balancon atë me ujë përbërës.
 - Menaxhon sekuenat e ngarkimit, për çdo përbërje, rregullon rrugën hyrëse të materialeve, kohën e përzierjes dhe shkarkimit.
 - Kontrollon kohën reale për çdo fazë funksionimi dhe optimizon kohët e prodhimit, konsumit të energjisë dhe të lëndëve të para.
 - Automatikisht ndan sasinë e kërkuar të ngarkimit, bazuar në aftësitë e impiantit të prodhimit.
 - Matje e dozimit me shpejtësi dyfishë të të gjitha materialeve, për peshim të shpejtë dhe saktësi absolute.
 - Menaxhon matje dozimi të njëkohshme të materialeve të njëjta për përmirësimin e kohës nxjerrjes.
- Drejtuesi Teknik kontrollon rezervat materiale dhe njofton për ato që ka më pak në gjendje.
- Drejtuesi i Panelit të Kontrollit automatikisht informon bazën e të dhënave për lëvizjen e materialeve në mënyrë manuale apo automatike.
- Automatikisht arkivon proceset ditore (konsumi në mënyrë automatike apo manuale, metrat kub të prodhimit për çdo recetë, etj)
- Menaxhon kartat mirëmbajtjes së të gjitha automjeteve dhe makinerive të kantierit, të bazuar në metër kub apo periudhë kohore
- Drejtuesi i Panelit të Kontrollit rregjistron manualisht lëvizjet e panelit të operimit.
- Menaxhon historikun duke iu referuar alarmeve, duke i dhënë mundësinë të kategorizojë dhe printojë
- Drejtuesi Teknik menaxhon pjesën e depozitimit të materialeve dhe rezervave
- Punonjesit
- Drejtojnë operacionet e ngarkim-shkarkimit të lëndës së parë
 - Mirëmbajnë, kontrollin dhe riparimin e linjes së instalimit/aparaturave
 - Rakordimi i sasisë së materialit të shkarkuar dhe produktit përfundimtar
 - Magazinimin dhe transportimin e lëndëve të para
 - Drejtimin e makinerisë së prodhimit të inerteve
 - Montojnë dhe cmontojnë detale dhe makinerite të demtuara
 - Drejtojnë operacionet për fraksionimin sa më eficient të lëndës së parë

- Menaxhojne procesin e fraksionimit depozitimit dhe ngarkimit te produkteve te perftuara.

4.6 Furnizimi me energji elektrike dhe telefoni.

E gjithë linja e prodhimit inerteve është e lidhur me sistemin e furnizimit me energji elektrike, Transformator 20 kW gjithashtu dhe ndricimi i sheshit.

I gjithë objekti ka nje projekt te vecante elektrik ne te cilin perfshihen instalimet elektrike me linja kablore te furnizimit per ndricim ne te gjithë ambientet e godines dhe impiantit. Per kete perdoren linjat ekzistuese te rrjetit prane objektit te cilet me miratimin e institucionit perkates jane lidhur me objektin ne fjale.

Linja e jashtme e furnizimit eshte kablore dhe vendoset direkt ne objekt, ky furnizim kur hyn brenda objektit eshte i ndare nepermjet nje paneli elektrik.

Mjetet e transportit, punojnë me lende djegese nafte e cila merret nga kompani serioze qe operojne ne tregun rajonal te Durresit me permbajtje te ulet te plumbit, duke rritur eficencen dhe jetegjatesine e mjeteve te transportit, si dhe uljen e emetimeve te gazrave ndotes ne atmosfere dhe ne territorin ku zhvillohet aktiviteti.

Kryerja e punimeve për prodhimin e produkteve inerte, gjithashtu, favorizohet nga:

- Pozicioni arkitektonik i instalimit dhe hapsira e bollshme ne dispozicion per zhvillimin e te gjitha proceseve per prodhimin e produkteve inerte, linjat teknologjike te impiantit punojne ne grup me hapsira ndermjet tyre te cilat nuk pengojne proceset e njera-tjetres .
- Kërkesa e madhe e tregut per produkte inerte
- Distanca e objektit me zonat e banuara, duke mos ndikuar ne aktivitetin e tyre bujqesor, ekonomik dhe shoqeror.
- Rajoni i Durresit eshte nje rajon ne zhvillim dhe kerkesa e madhe ne infrastrukture, energjitik, sektorin e ndertimit etj, favorizon zhvillimin e bizneseve te tilla te perqendruara ne prodhimin e produkteve inerte.
- Instalimet janë të një teknologjie bashkohore dhe te certifikuar dhe me ISO 9001-2008 si dhe 14000-2004.

5. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis dhe masat per minimizimin e tyre

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeran prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive te impiantit te prodhimit te inerteve. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular per pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

4.1 Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me produktet inerte gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ceshtjet e mjedisit te lidhura me depozitimin e lendes se pare dhe impiantit te prodhimit te produkteve inerte ne llogjiken e ciklit te jetes se produktit perfshijne:

- Praktikant e qendrueshme: Impakti me i madh mjedisor si perdorimi i materialeve inerte ne proceset e linjes teknologjike konsiston ne menaxhimin e burimeve natyrore te karrierave malore.

- Praktika te qendrueshme ne menaxhimin e lendes se pare gjate depozitimit dhe perdorimin sa me eficient te saj gjate procesit te prodhimit, duke riperdorur dhe ricikluar ate sasi te inerteve qe gjenerohet si mbetje gjate ketij procesi.

Praktika te qendrueshme ne reduktimin e emetimeve ne ajer nga procesi i depozitimit te lendes se pare, perdorimin e rrjetave per kapjen e pluhurave gjate fraksionimit dhe sperkatjen e vazhdueshme te sheshit gjate periudhes se nxehte me qellim uljen e grimcave PM10 ne ajer.

4.1.1 Shkarkimet ne ujera

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Ujrat e gjeneruara nga procesi teknologjik i larjes se inerteve (pastrimi nga papastertite).
- b) Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambjentin e kantierit.
- c) Ujrat e pastrimit te ambjentit te parkimit te makinerive dhe paisjeve.
- d) Ujrat e sperkatjes per kapjen e grimcave te pluhurit
- e) Ujrat e perdorura per qellime sanitare.

Lidhur me ujerat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrat teknologjike, por kalojne ne grope septike e cila eshte e ndertuar prej betoni dhe kryhet filtrimi natyror i ujrave sanitare.

Gjithashtu ujerat teknologjike, mbas proceseve te ndarjes ne dekantor puseten kryesore kalojne ne vasken e dekantimit nepermjet sistemit te brendshem te drenazhimit, sistemi eshte i mbyllur me riqarkullim, uji riciklohet dhe nepermjet dy pompave rifutet perseri ne procesin e larjes se inerteve duke reduktuar ne 95% sasin e ujit te perdorur. Ne asnje rast ujrat teknologjike te larjes se inerteve nuk shkarkohen ne mjedisin ujrator lumor.

Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete objekt, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla.

Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera konsiston ne gjenerimin e ujrave te larjes se inerteve te fraksionuar, ku ndikim eshte krejtesisht i lokalizuar.

Procesi teknologjik, sipas relacionit te paraqitur dhe deklarimit te investitorit, perfshin nje sasi te madhe te perdorimit te ujit e cila ndihmon ne rritjen e cilesise dhe pastertise se produkteve perfundimtare.

4.1.2 Ndotja e tokes

Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem;

Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i shkarkimit te lendes se pare eshte Pedana e Furnizimit dhe Bunkeri Ushqimit dhe si rrjedhoje nuk do te kemi ndotjke te tokes.. Kamionet jane veteshkarkues dhe materiali i lendes se pare inerte shkarkohet ne Bunkerin Ushqyes ku dhe fillon hapi i pare i procesit te fraksionimit. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne toke.

Automjetet dhe makinerite jane te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te lendeve qe transportojne.

4.1.3 Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit vjen nga grimcat e pluhurit te gjeneruara ne Gurethyesin me nofulla dhe Mullirin Sekondar, gjate fazes se depozitimit te lendes se pare dhe ne transportieret qe transportojne materialet ne proceset e caktuara te impiantit te prodhimit te inerteve.

Procesi punes se impiantit nuk perfshin procese te perdorimit te lendes djegese. Persa i perkete zhurmave, ato jane te ndjeshme vetem ne afersi te linjes se prodhimit deri ne nje distance prej 30 m dhe nuk jane problem per mjediset ne afersi te impiantit, pasi godina me e afert e banuar eshte 360m larg.

4.1.4 Mbetjet e ngurta urbane

Mbetjet e ngurta vijne nga: Aktiviteti human, mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones.

Mbetjet inerte qe gjenerohen gjate procesit te prodhimit jane ne sasi te vogla dhe ato grumbullohen dhe riperdoren perseri ne impiantin e prodhimit te produkteve inerte ndersa ajo sasi qe nuk eshte per tregtim apo riciklim riperdoret per shtrim e hapsirave te pashtuara ne sheshin ne krah te impiantit.

4.2 Identifikimi i masave për të eleminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

- Planifikimi i zones së instalimit

Për shmangien dhe parandalimin e gjenerimit të grimcave te pluhurit dhe zhurmave, si dhe për ruajtjen e regjimit të linjës së prodhimit dhe prametrave inxhiniero mekanike të saj, në projekt është përcaktuar funksionimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë i objektit në tërësi dhe i linjës së prodhimit të produkteve inerte.

Në objektin ku ndodhet instalimi është parashikuar hapa pas hapi, rigjenerimi i mjedisit të brendshëm e të jashtëm, sistemimi i lëndës së pare, parkimi i automjeteve, magazinimi i pajisjeve/makinerive ndihmese dhe ngarkimi produktit të prodhuar granil 1 dhe 2, rere natyrale dhe

rere e thyer, duke realizuar shfrytëzimin sa më eficient të mjedisit të shfrytëzuar nga shoqëria "BALLA - SK" Sh.p.k.

Pergjate perimetrit te zones ku eshte instaluar impianti i prodhimit te inerteve eshte mbjelle kurore pemesh te gjelberta me lartesi mbi 4 m dhe me distance na njera tjetra prej 3 m. Kjo sipërfaqe e përftuar nga trajtimet e mësipërme, do të japë mundësi për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e emetimit të grimcave të pluhurit, kapjen e ndotesve atmosferik dhe përmisimin e pamjes së përgjithshme të mjedisit të zonës në shfrytëzim.

Duhet theksuar se sipërfaqja e objektit në shfrytëzim nga firma "BALLA - SK" shpk është relativisht e vogël dhe nuk përbën ndonjë ndikim në zone.

Masat e propozuara per mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim

- Perdorimi i tokes: Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
- Mbrojtja nga erozioni: Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së impiantit të prodhimit. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku jane te istaluara linja e prodhimit te produkteve inerte.
- Demtimi potencial i vegjetacionit: Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt.
- Cilesia e ajrit: Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së impiantit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. Sperkatja periodike e sheshit dhe sperkatja me rrjeta uji.
- Sistemi i drenazhimit: Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike te pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët dhe riciklimi, ripërdorim i ujrave.
- Mbetjet: Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga impianti, nga kompani te licensuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim ne maksimum i mbetjeve inerte.
- Ujrat e ndotura urbane: Trajtimi i ujrave te perdorura teknologjike, duke i deguar ne vasken e dekantimit. Maksimizimi i perdorimit te ujit.
- Zhurmat: Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.

4.3 Masat lehtësuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te linjes se prodhimit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e impiantit. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit të linjes së prodhimit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë përmendur në mënyrë të përmblodhur si më poshtë :

1. Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes së prodhimit.
2. Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier të mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve.
3. Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi i mbetjeve inerte
4. Kapja e grimcave të pluhurit nepermjet sprucimit të ujit
5. Menaxhimi sa më eficient i lëndës së parë.
6. Mirembajtja ndërrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes së tyre.
7. Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti për prodhimin e produkteve të betonit.
8. Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.
9. Rikuperim, Trajtim, Riciklim dhe Riperdorim i ujrave të gjeneruara nga instalimi

4.4 Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:

- Parandalimi i shkarkimeve të lëndës së parë në mjedis.
- Lidhur me mbetjet e grumbulluara të menaxhohen në bashkëpunim me subjekte të licensuara ose me subjektin e grumbullimit të mbetjeve urbane.
- Sasia depozituese të mos i kalojë vëllimet e parashikuara në mënyrë që situata të jetë e kontrollueshme dhe të mos demtojë instalimin.
- Të zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri në mënyrë që të përballojë sipërfaqen në rastet e avarive të ndryshme.
- Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës. Punimet e mirembajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.
- Të mirembahet brezi i pemeve përgjatë murit rrethues të pronës, në mënyrë që të reduktojë impaktin në peizazh.
- Të bëhet sperkatja e sheshit gjatë muajve Qershor-Tetor me qëllim reduktimin e grimcave të pluhurit në ajër.

4.4.1 Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit të produkteve inerte:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmangët në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet lagja e sipërfaqeve të sheshit para objektit gjatë stinës së verës, pastrimi i vendit së depozitimit të lëndës së parë, si dhe të rrugëve komunikuese.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së impiantit të prodhimit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të kryhet larja e gomave të automjeteve dhe mbulimi i tyre para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.

- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulet.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Mbetjet inerte të Rikuperohen, Riciklohen dhe Riperdoren perseri në linjen e prodhimit, ajo sasi e mbetjeve që nuk mund të riciklohet të përdoret për mirembajtjen e sheshit para impiantit.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar në këtë Formular-Kërkesë për tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesisë Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike. Impiantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjike”, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me efikasitet.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për prodhimin e produkteve inerte vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së tokës që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Shfrytëzimi do të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangë në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijim e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin zonave përreth.
- Do të instalohet sistem i ujitjes për mjedisin përreth (varet dhe nga hapësira e planifikuar për gjelbërim si dhe pozicioni që ato do të kenë) si dhe lagia me ujë e rrugicave të brendshme gjatë periudhës Maj-Tetor.
- Linja e Impiantit të Inerteve të instaluar në objekt, do të kolaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve prodhimit të inerteve
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë

- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të realizohet lagia e sipërfaqes së sheshit para objektit dhe rrugët e brendshme të tij, me qëllim për të evituar ngritjen e pluhurit gjatë levizjes së mjeteve etj.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjobëruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjëlbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Transporti i lëndës së pare dhe produktit perfundimtar do të bëhet nga mjete të pastra nga balta (gomat e automjeteve do të pastrohen para daljes në rrugë të asfaltuar).
- Zona ku do të realizohen operacioni i prodhimit të produkteve inerte dhe rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së prodhimit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshtë ndertuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga Ujërrave të Ndotura Urbane të kësaj zone është realizuar lidhja me vaskën e dekantimit e cila bën dekantimin e ujrave të ndotura teknologjike. Ujrat grumbullohen nëpërmjet sistemit të drenazhimit i cili e përshkon të gjithë sipërfaqen e objektit ku janë të instaluar impianti/aparaturat dhe me rrjedhje të lire ujrat drejtohen për nga puseta dhe me pas në vaskën e dekantimit, më pas ujrat riciklohen dhe riperdoren në proceset e largjes së inerteve.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantin e prodhimit të produkteve inerte.

5. Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për impiantin e prodhimit të inerteve është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe

standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për prodhimin e inerteve, i pozicionuar në fshatin Bozanhie, Rashbull, Durres nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në linjen e prodhimit dhe makinerite, por dhe në një zonë mbi 50 m për rreth linjes së prodhimit.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të impiantit të instaluar.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të shpërndarjes së pluhurit gjatë aktivitetit të prodhimit
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së pluhurit dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura urbane që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt
- Monitorimi i sipërfaqeve të mbjella, pemëve dhe bimëve të kultivuara, ecurisë normale e mbirjes dhe zhvillimit të tyre. Në rastet kur vërehet se ka demtime merren masa për zëvendësime dhe fidanë të rinj. Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjellë do të vazhdojë për një periudhë 4 vjetore, kohë gjatë së cilës bimët kanë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë më nevojë për shërbime.

Monitorimi dhe rekomandime

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohet nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMP dhe Ministria e Mjedisit etj.

Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.

Meqenëse kemi të bëjmë me impiant prodhimi të inerteve, krijimin e pluhurave gjatë magazinimit, gjatë prodhimit, kërkohet monitorimi i pluhurave, i zhurmës cilësore së ujrave teknologjike megjithëse në kemi thënë më lart që janë minimale.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

Nr	Elementi i Monitorimit	Frekuenca	Analiza	Përgjegjësi
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga instalimi	Periodike	Analize e plote. Parametrat kimike: nitrate, nitrite, BOD, COD, metale,	Firma

			hidrokarbure.	
2	Monitorim i shkarkimit të grimcave të pluhurit, gjatë magazinimit dhe procesit të prodhimit	Vazhdueshëm	Ne pika te ndryshme te linjes se prodhimit te inerteve	Firma
3	Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit	Vazhdueshem	NOx, SOx, CO, CO2, O etj	Firma
4	Parametrat fizike si: temperature, pH, të ujrave që do të shkarkohen nga sprucimi dhe larja e inerteve	Vazhdueshëm	Parametrat fizike: temperature, pH, llumrat dhe lenda e ngurte.	Firma
5	Monitorim i gjendjes së mekanikës dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.	Vazhdueshëm	Aromat, temperature, pluhurat, Zhurmat dB(A)	Firma
6	monitorimin e mbjelljes së kurorës së pemëve	Periodike		Firma
7	Sasia e lendes se pare te perpunuar/konsumuar	Periodike	Sasiore	Firma
8	Sasia e produktit te prodhuar	Vazhdueshem	Sasiore	Firma

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i cdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderueshëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.

BAZUAR NË LIGJIN 10 440, DATE 7.7.2011 “PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS” AKTIVITETI “PRODHIMI I PRODUKTEVE INERTE” NE KLASIFIKOHET NE ASNJE NGA SHTOJCAT I DHE II “PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS DHE PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS”.

PER SA ME LART SUBJEKTI “BALLA – SK” ME AKTIVITETIN E TIJ “PRODHIMI I PRODUKTEVE INERTE” APLIKON PER TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TE TIPIT B, REFERUAR KREUT III, TE VENDIMIT NR. 419, DATE 25.6.2014, “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKL-JA” SIPAS SHTOJCES I, TE LIGJIT 60/2014, DATE 25.6.2014 “PER LEJET E MJEDISIT” (TE NDRYSHUAR) PER VEPRIMTARINE ME ID 3.10 “PRODHIMI I PRODUKTEVE TE TJERA MINERARE JOMETALIKE”.

REFERUAR KREUT III “PROCEDURAT PER SHQYRTIMIN E KERKESAVE DHE PERCAKTIMIN E KUSHTEVE PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B” PIKA1.DH TE VENDIMIT NR. 419, SUBJEKTI “BALLA – SK” APLIKON PER ZHVILLIMIN E DEGJESES ME PUBLIKUN, SIPAS PIKES 13 TE KREUT VI TE KETIJ VENDIMI.

Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise “BALLA – SK”

Skender BALLA
